



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Fjala hyrëse nga Kryesuesi

ZRRE ka përzgjedhur një qasje të bazuar në detyra sipas kalendarit të saj rregullativ. Plani i punës i miratuar nga Bordi i ZRRE-së përmban në vetvete politikën e përgjithshme, dhe detyrat e veçanta për aktivitetet rregullative. ZRRE-ja gjatë kësaj periudhe ka kryer konsultime publike dhe ka marrë vendime lidhur me shqyrtimin e përgjithshëm të të Hyrave për të gjithë të Licencuarit, si dhe për tarifrat që kanë të bëjnë me burimet e ripërtëritshme.

Në përgjithësi në 6 mbledhje të mbajtura gjatë periudhës janar- qershor 2016, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka marrë 78 vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me sektorin e Energjisë.

Vlen të përmendet vendimi për tarifrat, me të cilin vendim Bordi i ZRRE ka vendosur që për vitin 2016 të ruajë të njëjtat tarifa për konsumatorët shtëpiakë (familjarë) dhe të njëjtën strukturë tarifore, ndërsa ka vendosur ulje nga 7.17% deri në 8% të tarifave për konsumatorët industrial dhe komercial. Vendime të rëndësishme janë marrë në dhënjen e autorizimeve preleminare dhe finale për ndërtim të kapaciteteve gjeneruese nga Burimet e ripërtëritshme, si dhe për çmimet e burimeve të ripërtëritshme për Energjinë e prodhuar nga Hidro Gjenerime dhe zgjatja e marrëveshjeve për shitblerje të energjisë nga burimet fotovoltaike.

Dëshiroj të falënderoj kolegët e mi për përpjekjet e tyre të suksesshme, tashmë të komentuar pozitivisht prej palëve të tjera të interesuara, dhe uroj që të kemi suksese ndaj sfidave madhore me të cilat ZRRE-ja do të përballet gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016.



Enver Halimi , Kryesues i Bordit





Bordi i ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së përbëhet nga kryesuesi dhe katër anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Bordi i ZRRE-së, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ZRRE-së.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2016, Bordi i ZRRE ka funksionuar në përbërje të plotë prej 5 anëtarëve.

- z. Enver Halimi, kryesues,
- z. Krenar Bujupi, anëtar,
- z. Arsim Janova, anëtar,
- z. Qemajl Mustafa, anëtar dhe
- z. Besim Sejfiqaj, anëtar.

Seancat e Bordit janë të hapura për publikun dhe njoftimet për përmbajtjen e tyre, së bashku me rendin e ditës shpallen në ueb faqe të ZRRE-së, çdo herë pesë ditë para mbajtjes së seancës.

Gjatë periudhës janar – qershor 2016 Bordi i ZRRE-së ka mbajtur 6 mbledhje formale, në të cilat janë marrë 78 vendime.

Vendimet e marrura luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit, duke lehtësuar strukturën e duhur institucionale dhe organizative që duhet të vendoset, në menyre që të



Për qëllime të vendimmarrjes, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas legjislacionit në fuqi Bordi mban mbledhje formale, takime konsultative, si dhe seanca dëgjimore publike.

tërheqën investime private të cilat nevojiten për të shfrytëzuar burimet natyrore.

Dokumentet e botuara dhe të diskutuara në dëgjimet Publike si dhe vendimet e Bordit janë si në vijim:

Konsultimet Publike

- Raporti Konsultativ për të Hyrat Maksimale të Gjenerimit
- Raporti Konsultativ i Shitjes me Shumicë
- Raporti Konsultativ i të Hyrave Maksimale të KOSTT
- Raporti Konsultativ i të Hyrave Maksimale të KEDS-it
- Raporti Konsultativ i të Hyrave Maksimale të Furnizuesit Publik
- Shqyrtimi i Tarifave Nxitëse për Energjinë e Ripërtëritshme (era dhe hidrocentralet e Vogla)
- Rregulli për përcaktimin e Çmimeve të Energjisë Termike

Vendimet e marrura nga Bordi i ZRRE-së

Vendimet për Licencim të aktivitetit të importit, eksportit dhe transitit të energjisë elektrike në Kosovë

[V 774 2016](#) – për "AXPO KOSOVO" L.L.C.

[V 823 2016](#) – për "ENERGO SUPPLIER" SH.P.K.

[V 821 2016](#) – për "FUTURE ENERGY TRADING" SH.P.K.

[V 809 2016](#) – për "GSA ENERGJI" SH.P.K.

[V 808 2016](#) – për "PAN INTERTRADE" SH.P.K.

[V 807 2016](#) për "EDS International KS" L.L.C.

[V 775 2016](#) – për "ENERGY FINANCING TEAM" L.L.C.

[V 822 2016](#) – për "PETROL TRADE SLOVENIJA" L.L.C.

Vendimi për lirimin nga pagesa e taksës vjetore të Licencimit

[V 787 2016](#) – për ndryshim dhe plotësim të vendimit V_732_2015.

Vendimi për Tarifë nxitëse për prodhim të energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.

V_810_2016 Lidhur me përcaktimin e Tarifave Nxitëse (Feed in).





Vendimet mbi njoftimin për autorizimet preliminare:

- V_766_2016 – për “ 2 Korriku” sh.p.k. (HC “Soponica”).
- V_767_2016 – për “Eurokos JH” sh.p.k (HC “Brodi 1” dhe HC “Brodi 3”).
- V_768_2016 – për “Eurokos JH” sh.p.k (HC “Restelica 3”).
- V_769_2016 – për “AFA Energy” sh.p.k. (HC “Kotlina 1”).
- V_770_2016 – për “AFA Energy” sh.p.k. (HC “Kotlina 2”).
- V_771_2016 – për “CETA General Invest Group” sh.p.k. (HC “Lubinja”).
- V_772_2016 – për “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë (HC “Jasiq”).
- V_773_2016 – për “Triangle General Contractors” Inc., Dega në Kosovë (HC “Mal”).
- V_788_2016 – për N.T.N. “Renelual Tahiri” sh.p.k. (HC Dragash).
- V_789_2016 – për N.T.N. “Renelual Tahiri” sh.p.k. (HC Orqusha).
- V_806_2016 – për DILLI COM (HC Bresana).
- V_811_2016 – për “Fidani Water Energy” sh.p.k., (HC “Radoniq”).
- V_825_2016 – për “VITA ENERGY” SH.P.K., panelet solare/fotovoltakike.
- V_826_2016 – për “VBS” SH.P.K, panelet solare/fotovoltakike.

Vendimi për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së vendimit mbi Njoftimin e Autorizimit Preliminar:

- V_761_2016 – për “ Era Energji” sh.pk., (“Wind Park Krajkova”).

Vendimet për lëshim të Autorizimit Final:

- V_754_2016 – për “ Hidroenergji” sh.p.k. (HC “Lepenci 1”).
- V_755_2016 – për “Hidroenergji” sh.p.k. (HC HC “Lepenci 3”).
- V_756_2016 – për “ONIX SPA” LLC, (“Parku Solar Banja e Pejës”).
- V_757_2016 – për “Hidro Line” sh.p.k., (HC “Albaniku 2”, ZK Selac).
- V_758_2016 – për “Matkos Group” sh.p.k. (HC “Brezovica”).
- V_759_2016 – për “Matkos Group” sh.p.k. (HC “Sharri”).
- V_760_2016 – për “Matkos Group” sh.p.k. (HC “Shtërpce”).
- V_824_2016 – për “AIR ENERGY” sh.p.k., (“Wind Park Kitka”).

Vendimet për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final:

- V_762_2016 – për “Eurokos JH” sh.p.k. (HC “Restelica 1&2”).
- V_763_2016 – për “KelKos Energy” sh.p.k., (HC “Lumbardhi II”).
- V_764_2016 – për “Hidro Line” sh.p.k., (HC “Albaniku 3”).

Vendimet për të hyrat maksimale, çmimet dhe tarifat

- [V_797_1_2016](#) – për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) KEK
- [V_798_2016](#) – për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) KOSTT
- [V_799_2016](#) – për të Hyrat Maksimale të Lejuara (MAR) KEDS
- [V_800_2016](#) – për të Hyrat Maksimale (MAR)- KESCO
- [V_801_2016](#) – për çmimet e KEK Gjenerimit
- [V_802_2016](#) – për tarifat e KOSTT-it
- [V_803_2016](#) – për tarifat e KEDS-it
- [V_804_2016](#) – për tarifat e konsumatoreve të rregulluara KESCO.

ZRRE dhe ERE intensifikojnë bashkëpunimin bilateral

Përfaqësues të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës dhe Entit Rregullator për Energji (ERE) të Shqipërisë kanë mbajtur një takim pune me datë 6 maj 2016, në Tiranë, për të zhvilluar dhe forcuar me tej marrëdhëniet bilaterale dhe për të përcaktuar sferat kryesore me të cilat do të fokusojnë bashkëpunimin e tyre të mëtejshëm.

Kryetari i ZRRE-së z. Enver Halimi dhe ai i ERE-s z. Petrit Ahmeti, kanë vlerësuar si të domosdoshëm intensifikimin e bashkëpunimit në mes të dy rregullatorëve. Ky bashkëpunim është cilësuar mjaft i rëndësishëm, veçanërisht tani, kur të dy vendet po punojnë për të realizuar funksionimin e tregut të përbashkët energjetik. Përafrimi i legjislacionit, sidomos atij sekondar, krijimi i tregut të përbashkët të energjisë, si dhe aderimi në institucionet ndërkombëtare janë vlerësuar si prioritet i përbashkët i këtij bashkëpunimi.

Nga pjesëmarrësit është konkluduar se këto synime do të bëhen më lehtë të arritshme përmes shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizave të dy rregullatorëve. Ekspertët e dy Rregullatorëve kanë prezantuar para homologëve të tyre sfidat me të cilat janë duke u përballur aktualisht dhe kanë shkëmbyer mendimet profesionale në lidhje me zgjidhjen më të përshtatshme të praktikave të rregullimit ekonomik të sektorit të energjisë.

Transpozimi i legjislacionit të BE-së, ruajtja e pavarësisë, hapja dhe monitorimi i tregut janë identifikuar si sfidat kryesore me të cilat aktualisht janë duke u përballur dy rregullatorët. Për këtë është vlerësuar se bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave do të ndihmojnë rregullatorët në arritjen e synimeve të përbashkëta.





Transparenca dhe Përfshirja e publikut në Proceset rregullative të sektorit.

Partneriteti në mes të Agjencisë Kombëtare të Rregullatorëve të Shërbimeve Publike (NARUC - National Agency of Regulatory Utility Commissioners) dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), me mbështetje financiare të USAID, ka filluar që nga viti 2008. Gjatë kësaj periudhe ZRRE ka qenë në partneritet me Komisionin e shtetit të Illinois dhe me Komisionin e shtetit të Pensilvanisë. Aktivitetet e këtyre dy partneriteteve kanë përfshirë shkëmbim të eksperiencave teknike në mes të ekspertëve të ZRRE-së dhe atyre të NARUC-ut, në çështje të ndryshme rregullative.

Duke pasur parasysh se marrëdhëniet me publikun dhe transparenca mbasin një ndër fokuset dhe sfidat kyçe të ZRRE-së, NARUC ka vendosur që të zhvilloj një aktivitet vëzhgues të punës për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, për të cilin KPSC (komisioni rregullativ për shërbime publike) është ofruar që të shërbej si Komision mikpritës për stafin e ZRRE. Përfaqësuesit e ZRRE janë familjarizuar me praktikat dhe mjetet e përdorura nga stafi i KPSC, gjatë proceseve të tyre të marrëdhënieve me publikun, duke përfshirë punën dhe ndërveprimin që KPSC ka me konsumatorët, mediat, dhe palët e tjera të kyçura në sektor. Si rezultat i këtij shkëmbimi praktikash, ZRRE ka draftuar rregulla për rritjen e transparencës dhe intensifikimin e përfshirjes së Publikut në proceset rregullative të sektorit të energjisë elektrike.



Drejt një tregu të hapur të energjisë elektrike - Bashkëpunimi Kosovë Shqipëri

Institucionet kosovare të përfshira në sektorin e energjisë janë të përkushtuara në krijimin e një tregu të hapur të energjisë elektrike.

Funksionalizimi i tregut të hapur, bashkëpunimi me vendet e rajonit për të krijuar tregje të përbashkëta – (Market coupling) dhe tregje të shkëmbimeve të energjisë (Power Exchange) është edhe një nga kërkesat e vazhdueshme edhe të Komunitetit të energjisë si dhe Samitit të vendeve të Ballkanit WB6.

Në kuadër të zhvillimeve rajonale dhe vendore për liberalizimin e tregut, Kosova është duke bërë përpjekje që të ketë progres në këtë drejtim. Për të përkrahur hapjen e tregut nevojitet edhe bashkëpunimi me vendet e rajonit, posaçërisht për bashkimin e tregut (Market coupling). Për këtë janë duke u zhvilluar takime në mes institucioneve vendore përgjegjëse për sektorin e energjisë, por edhe me përfaqësues të rajonit për të gjetur modalitetet e këtij bashkëpunimi si dhe zgjidhjen më të mirë dhe të lehtë drejt hapjes së tregut. Një nga veprimet që janë ndërmarrë në këtë drejtim, gjatë kësaj periudhe, është punëtorja e përbashkët Kosovë - Shqipëri me temën Formimi i tregut të shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri (Power Exchange) i cili është mbajtur me 19 maj 2016 në Prishtinë.

Në këtë punëtori, ekspert dhe konsulent të lëmisë adekuate kanë prezantuar gjendjen ekzistuese të sistemeve energjetike të të dyja vendeve, duke potencuar kompatibilitetin e tyre.

Me këtë rast është thënë se të dy sistemet energjetike janë mjaft të vogla për të funksionuar në mënyrë fizibile si të vetme në tregun konkurrues. Lidhja e mirë e rrjetit (sidomos me futjen në funksion të linjës 400 kV Kosovë - Shqipëri dhe kompatibiliteti i sistemeve energjetike të të dyja vendeve është një përparësi e madhe për të arritur sukses në bashkimin e tregut Kosovë – Shqipëri. Ekspertët kanë theksuar se bashkëpunimi duhet të shtrihet, përveç në bashkimin e tregut, në tregun një ditë para (Day ahead), edhe në shkëmbime dhe ofrim të shërbimeve ndihmëse. Ky bashkëpunim do të ndihmonte edhe në balancimin e sistemit duke zvogëluar nevojën për kapacitete rezervë për shërbime ndihmëse. Kjo posaçërisht është ndihmesë për sistemin energjetik të Kosovës duke pasur parasysh njësitë e mëdha gjeneruese, ku rënia e një njësie nga puna shkakton mungesë të madhe të energjisë elektrike në sistem dhe është vështirë të kompensohet. Po ashtu ky bashkëpunim është i favorshëm edhe për Shqipërinë për të siguruar energji bazë sidomos në periudhat e viteve të thata. Përparësitë e këtij bashkëpunimi janë të mëdha edhe në zvogëlimin e nevojave për importe të energjisë me çmime të larta si dhe optimizimin maksimal të kostove për të dyja sistemet. ZRRE është angazhuar maksimalisht në këtë drejtim duke punuar në përgatitjen e procedurave të përshtatshme, të cilat hapin rrugë për operatorë të ri në treg.





Përcaktimi i tarifave nxitëse

ZRRE në pajtim me ligjet primare të energjisë dhe legjislacionit sekondar përcakton tarifat nxitëse për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme. Tarifat nxitëse janë një ndër stimujt kryesorë të investimit në prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme dhe aplikohen në shumë shtete. Tarifat nxitëse të përcaktuara nga ZRRE-ja, iu garantojnë investitorëve potencial se sasia e energjisë e prodhuar nga burime të energjisë së ripërtëritshme dhe të pranuar në skemën mbështetëse, do të blihet nga Furnizuesi Publik me çmim i cili mundëson kthimin e kostove të investimit dhe operimit.

Gjatë muajit maj 2016 është kryer rishqyrtimi i tarifave nxitëse “FEED-in” për Hidrocentrale dhe për gjeneratorët me erë dhe për këtë çështje në maj 2016 është publikuar Raporti Konsultativ Metodologjia për llogaritjen e tarifave nxitëse për prodhimin e energjisë nga teknologjia e erës dhe ujit. ZRRE ka publikuar “Përgjigjet ndaj komenteve të palëve të interesit”.

Tarifat janë të klasifikuara sipas burimeve të ndryshme të ripërtëritshme duke i garantuar edhe Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë (MBE) nga furnizuesi publik me periudhë prej dymbëdhjetë (12) vite për teknologjinë solare fotovoltaike, ndërsa dhjetë (10) vite për teknologjitë tjera.

Niveli i tarifave nxitëse të aplikueshme për BRE

Burimi primar i energjisë së ripërtritshme	(€/MWh)
Energjia fotovoltaike	136.40
Era	85.00
Hidrocentrale të vogla të reja	67.47
Biomasa	71.30

Pjesëmarrja e ZRRE-së në takime, punëtori dhe seminare të ndryshme

Bordit i ZRRE-së dhe stafi kanë marrë pjesë edhe në takime tjera brenda dhe jashtë vendit, për qëllime që kanë të bëjnë me rregullimin e sektorit të energjisë. Vlen të përmendet se gjatë kësaj periudhe ka pasur shumë takime me investitor të mundshëm sa i përket investimeve në energji të ripërtërishme, me palë të interesuara për licencim, me konsumator të ndryshëm të cilët i janë drejtuar ZRRE-së për sqarime apo edhe ankesa të ndryshme në sektor të energjisë.

Kosova është palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE), në kuadër të të cilit organizohen takime të ndryshme të nivelit të lartë dhe grupeve të ndryshme punuese për çështje të energjisë. Pjesëmarrës në këto grupe është Kosova, ndërsa Rregullatori është pjesëmarrës me anëtarë të Bordit dhe të stafit të ZRRE-së në grupet si më poshtë:

- Bordi rregullativ i Komunitetit të Energjisë;
- Grupi punues për energji elektrike;
- Grupi Punues për konsumator dhe tregjeve me pakicë;
- Grupi punues për gaz;
- Grupi punues për siguri të furnizimit;
- Takimi për energji elektrike dhe gaz ;

Në kuadër të këtyre grupeve, në vijim janë paraqitur disa nga takimet organizuara gjatë kësaj periudhe në të cilat ZRRE ka qenë pjesëmarrëse, të cilat janë mbajtur në Vjenë, Austri.

9, 10 Shkurt 2016 takim i grupit ECRB GAS Working Group dhe 26 “PECI 2016-02-26 1St PECI evaluation group for electricity and Gas”;

11 shkurt 2016 –takimi i 33t të i Grupit Punues për Konsumator dhe Tregje me pakicë në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB).

24 shkurt 2016 – takimi i 37të i grupit për energji elektrike EWG të ECRB.

24 shkurt 2016 – pjesëmarrje në punëtorinë Kodet e rrjetit implementimi nacional.

13-14 mars 2016 – pjesëmarrje në punëtorinë “Kapacitetet e transmissioinit të Gazit në Komunitetin e Energjisë”.

08 prill 2016 Pjesëmarrje në takimin e Grupit Punues për vlerësimin projekteve të interesit për Komunitetin e Energjisë (PECI).

22 qershor 2016 – takimi i 34të i Grupit Punues për Konsumator dhe Tregje me pakicë në kuadër të Bordit Rregullativ të Komunitetit të Energjisë (ECRB CRMW).

Po ashtu është përfaqësues nga ZRRE kanë marrë pjesë edhe në Forumin e Nivelit të Lartë “Siguria e furnizimit me energji elektrike në Kosovë”.





Kontakti dhe adresa e ZRRE-së

Zyra e Rregullatorit për Energji

Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12

Prishtinë 1000, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 247 615

Mob: +386 (0) 49 78 70 80

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: info@ero-ks.org

Web: www.ero-ks.org

Për Konsumatorë:

Tel: +381 (38) 247 615 lok. 116

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: ankesa.dmk@ero-ks.org

Për çështje Ligjore, Licencim, BRE/Autorizim:

Tel: +381 (38) 247 615 lok. 114, 117, 118

Fax: +381 (0) 38 247 620

Email: legal-licensing@ero-ks.org